

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SAFIR DISTIK.A.S. Shpk
NENI 1

Ne Tirane sot ne dt 28 / 01/2015,Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SAFIR DISTIK.A.S. Shpk .perserit Statutin mbi bazen e iniciatives dhe te kapitalit themeltar te ortakeve Z. Ridvan Ikikardesh dhe Nimetullah Ikikardesh.

, me zotesi te plote per te ushtruar aktivitetin privat si persona juridik e i pavarur.

NENI 2

Shoqeria ka formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me ortakeri.
Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga ky statut nga dispozitat perkatese te ligjit nr 9901 date 14.04.2008,i ndryshuar,Per shoqerite tregtare.
Shoqeria ka filluar te veproje si person juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne QKR nga 07/10/1994.

NENI 4

Emertimi i shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar eshte:

"SAFIR DISTIK.A.S. Shpk Shoqeria do te kete vulen e saj permbajtje e se ciles do te jete si vijon:

"SAFIR DISTIK.A.S. Shpk ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe do te nxjerre shoqeria shenohet emri i plote i shoqerise ose i shkurtuar,vlera e kapitali themeltar dhe administratori

NENI 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SAFIR DISTIK.A.S. Shpk do ta kete seline e saj ne Adresen Rr.Naim Frasheri,Nr 259.Tirane.Sidoqofte selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te ortakeve dhe te depozitohet ne QKR.

**OBJEKTI
NENI 6**

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

"SAFIR DISTIK.A.S. Shpk do te jete

Objekt i veprimtarise:

Investime ne fushen e stomatologjise,Klinike dhe Laborator Dentar,transportit Rrugor,investime ne ndertime,import-export me shumice dhe pakice,tregetim te artikujve te ndryshem,etj
Import-export,Gjeneral kontraktor ne sektorin e ndertimeve te tregtise dhe te sherbimeve te prodhimit per artikuj veshje pune,ushtarake,impiante teknologjike,elektrike,kondicionimi,aspirimi dhe hidraulike.



NENI 7

Shoqeria themelohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe deri 5 vjet duke filluar nga koha e depozitimit te ketij statuti ne QKR.

Per shkaqe e arsye te ndryshme ajo mund te mbaroje aktivitetin e saj para ketij afati.kjo behet ne perputhje me normat e Statutit dhe te legjislacionit ne fuqi.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 46.000.000 lek.Kuotat e shoqerise ndahen ne dy ortake.

1- Z. Ridvan Ikikardesh dhe 2-Nimetullah Ikikardesh.

Kapitali themeltar prej 46.000.000 lek, per te dy ortakët ndahet ne perqindje 50me 50.

Per ortakun, Ridvan Ikikardesh, eshte

-Vlera e kapitalit 23.000.000 lek. Numri i pjeseve 1.

-Pjesemarrja ne perqindje % 50.

Per ortakun, Nimetullah Ikikardesh.

-Vlera e kapitalit 23.000.000 lek. Numri i pjeseve 1.

-Pjesemarrja ne perqindje % 50.

NENI 9

Kapitali i shoqerise depozitohet para fillimit te aktivitetit te shoqerise.

NENI 10

Kapitali themeltar mund te shtohet ose te zvogelohet,ne varesi te rezultateve dhe ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.ai mund te jete ne leke ose ne valute te huaj.

NENI 11

Kapitali themeltar mund te transferohet jashte Shoqerise ,ose te lihet peng ne perputhje me legjislacionin ne fuqi

NENI 12

Kapitali themeltar eshte lehtesisht i transferushem rruge trashegimie, basheshorti, paraardhsit dhe pasardhsit mund te behen ortakë ne shoqeri nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit dhe sipas kushteve te parashikuara ne ligj.

NENI13

Shoqeria mund te kete edhe kontribute te tjera ne natyre. Ketu perfshihen te gjitha sendet e paluajtshtme ne sherbim te Shoqerise si dhe ato te luajtshtme te cilat kalojne ne pronesi te Shoqerise.

FONDET E SHOQERISE

NENI 14

Shoqeria percakton fondet:

Fondin themeltar (qarkullues).

Fondin rezerve.

Fonde te tjera qe mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.



Madhesia e secilit fond percaktohet mbi bazen e vendimit te organit drejtues i cili merr vendim gjithashtu edhe per qellimin e perdorimit te tij.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

NENI 15

Shoqeria ka keto organe drejtuese.

Asambleja e ortakeve Z.Ridvan Ikikardesh dhe Nimetullah Ikikardesh.

Administratori

Administrator i shoqerise emerohet Z. Ridvan Ikikardesh, me afat riemerimi deri ne 5 vjet dhe me te drejte ndryshimi me vendim te asamblese se ortkeve.

NENI 16

Me vendim te ortakeve ,per administrimin e shoqerise ose te aktiviteteve te vecanta te saj mund te emerojne nje ose disa persona te tjere si administratore te Shoqerise. Kompetencat e administratoreve te mundshem percaktohen ne aktin e emerimit te tyre te leshuara nga vendimi i ortakeve.

NENI 17

Shoqeria nuk mer persiper veprimet qe mund te kryejne administratore te tjere te mundshem, ne mardhenie me persona te trete qe i tejkalojne kopetencat e tyre te percaktuara ne aktin e emerimit.

NENI 18

E gjithe veprimtaria e shoqerise percaktohet nga ortaket ne perputhje me Statutin dhe Legjislacionin ne fuqi.

NENI 19

Ortaket per te shqyrtuar bilancin vjetor, te ardhurat e qarkulluara, si dhe menyren e mbajtjes se regjistrave te veprimeve kontabel, emerone nje ose disa eksperte kontabel. Emerimi i eksperteve kontabel eshte i detyrueshem per rastet e parashikuara me ligj.

KOMPETENCAT E ORTAKEVE

NENI 20

Kompetencat e ortakeve jane keto:

Vendosin per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise dhe miraton rregulloret per sektoret e vecante te saj. Emerojne dhe shkarkojne administratoret dhe percaktojne kompetencat e tyre ne aktin e emerimit.

Shqyrtojne bilancin vjetor, kuotat e fondeve te ndryshme dhe fitimin e realizuar.

Vendosin per krijimin e filialeve, degeve ose perfaqesive te Shoqerise si dhe per krijimin e shoqerive te perbashketa.

Vendosin per marrjen e kredive dhe per mbarimin e aktivitetit te Shoqerise, nese ne dokumentacionet financiare, rezultatet e shoqerise vleresohen me humbje.

Realizojne mardheniet me te rendesishme financiare dhe ekonomike te shoqerise me persona te tjere juridik e fizike.



KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT NENI 21

Administratori ka per detyre:

Te punoje,te drejtoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare.

Te zbatoje vendimet e marra nga ortaket dhe urdherat e tyre te dhena brenda kompetencave te percaktuara nga Statuti i Shoqerise dhe Legjislacioni ne fuqi.

Te paraqese ne menyre te rregullt raportin e administrimit,te investitorit,bilancit dhe te llogarive vjetore,ortakeve brenda nje afati 6 muaj pas mbylljes se vitit financiar pasardhes.

Realizon dhe percakton cmimet e punimeve dhe sherbimeve te kryera.

Vendos pagat e personelit te shoqerise.

Ndjek problemet e Shoqerise ne mardhnie me organe te ndryshme shteterore dhe me persona te tjere juridik e fizike.

MARDHENIET FINANCIARE NENI 22

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“SAFIR DISTIK.A.S. Shpk** Mund te lidhe kontrata me sektore shteterore,drejtperdrejt me tregun e lire,si dhe me persona fizike e juridike vendas ose te huaj.

NENI 23

Ne mardhenie kontraktore,Shoqeria perfaqes ohet nga ortaket ose nga persona te autorizuar prej tyre.Te drejta dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 24

Shoqeria ka te drejte te çele llogari likujduese prane Bankave te vendit ose te huaja ne Shqiperi,Shteterore ose private dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet tyre.Per sigurimin e veprimtarise ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose ne valute te huaj.

NENI 25

Shoqeria pergjigjet per kontributet fiskale,afatete e derdhjes se tyre dhe sigurimet shoqerore.Personat e ngarkuar me kete detyre duhet te mbajne dokumentacionin te rregullt financiar Administratori ne fund te vitit duhet te dorezoje ne organin tatimore percates bilancin e te ardhurave per efekt tatimi vjetor.

Viti financiar mbaron ne muajin dhjetor te cdo viti.Raportet dhe inventaret vjetore hartohen nga ortaku i vetem ne perputhje me dispozitat e ketij statuti dhe Legjislacionin ne fuqi.



MARDHENIET E PUNESIMIT

NENI 26

Ortaket vendosin per personat qe do te punesohen ne aktivitetin e Shoqerise. Punesimi do te behet ne perputhje me aftesite profesionale te punemarresit.

NENI 27

Mardheniet e punesimit rregullohen sipas kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve, ne baze te kodit te punes dhe akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi. Ne kontrate caktohen kushtet e punes, pageses, sigurimit ne pune, diteve te pushimit etj.

NENI 28

Administratori dhe personeli i shoqerise eshte i detyruar te respektoje disiplinën e punes dhe te ruaje dhe te mirembaje pronen dhe te zhvilloje aktivitetin e Shoqerise ne perputhje me ligjin.

NENI 29

Ndaj shkeljeve te ndryshme zbatohen disa masa disiplinore qe merren nga ortaket. Punonjesi qe largohet nga puna duhet te beje dorezimet e detyres ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete shlyer detyrimet materiale monetare.

PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

NENI 30

Cdo punonjes i punesuar ne Shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbushë detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes, nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti i Shoqerise. Per shkelje te tilla dhe per shkelje te legjislacionit ne fuqi merren masa te ndryshme sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI

NENI 31

Te gjithë personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne fshehtesine e dokumentacionit, te informacionit, te njohurive te fituara si dhe cdo lloj tjeter materiali konfindencial. Ata duhet te adaptojne te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar hapjen e ketyre qofte dhe pjeserisht.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 32

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve te mundshme ndaj personave te trete, kalojne ne dispozicion te ortakeve Z. Ridvan Ikikardesh dhe Nimetullah Ikikardesh., sipas perqindjes se pjesmarrjes, ku gjithesecili mund ti depozitoje ne Banke te vendit ose te huaj, ne leke apo valute.

NENI 33

Pagesat e personelit behen sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e punes dhe te perqindjeve te fitimit te percaktuara nga ortaku i vetem.

NENI 34



Ne rast mbarimi te veprimtarise se shoqerise, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar perqindjet e mbartuara nga vitet e meparshme, kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem.

NENI 35

Cmimet e sherbimeve te ofruara nga Shoqeria si dhe ato te tregtimit caktohen ne baze te ekonomise se tregut te lire. Fitimet e realizuara i nenshtrohen tatimit vjetor te percaktuar ne dispozitat perkatese ligjore.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 36

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te asamblese se orakeve ne rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurese si dhe per shkaqet e parashikuara ne ligj.

NENI 37

Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit nepermjet formave te thithjes ose te bashkimit

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 38

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet ne ndonje institut sigurimi

NENI 39

Mosmarveshjet ne mardhenie me persona juridik a fizike, vendas e te huaj zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert gjykata kompetente eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane

NENI 40

Cdo gje tjeter ne kete shoqeri i referohet ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 si dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

NENI 41

Shoqeria do te kete vulen e saj forma dhe permbytja e se ciles percaktohen nga ortaket.

Statuti i Shoqerise u miratua nga ortaket Z. Ridvan Ikikardesh dhe Nimetullah Ikikardesh., dhe administratori i saj

Ridvan Ikikardesh dhe nenshkruhet rregullisht.

ORTAKET:

Ridvan Ikikardesh

Nimetullah Ikikardesh

